



Shk. 48 prot
Shkollë 20/06/11

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË



V E N D I M

Nr. 15 Datë 13.06.2018

“MIRATIM NË PARIM PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR PËR ENERGJI ELEKTRIKE” SUBJEKTIT “BREÇANI-R.O.S.P” SH.P.K.

Në mbështetje të nenit 7 pika 2, të nenit 50, pika 2, të ligjit nr.6/2018 për disa ndryshime dhe shtesa të ligjit nr.111/2012 dt.15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, të VKM Nr.416 datë 13.05.2015 si dhe të nenit 24, pika1/ c, të VKM Nr. 822 datë 07.10.2015, “ Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt konçesioni”, për paisjen me autorizim(miratim ne parim) të subjektit “BREÇANI-R.O.S.P” SH.P.K., me propozim të A.B.U Drin- Bunë, miratimin në parim të Këshillit Konsultativ dhe oponentës së DPBU në ministrinë përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore, Keshilli i Basenit Ujor Drin- Bunë,

V e n d o s i:

1-Miratimin në parim të kërkesës së subjektit “**BREÇANI-R.O.S.P**” SH.P.K me administrator Z. Fatbardh BREÇANI, për përdorim të burimit ujor, **Lumi i Gashit**, degë e lumit të Valbonës, për prodhim energjie elektrike në fshatin Begaj, Njësia Administrative Tropojë, Bashkia Tropojë, Qarku Kukës .

Sipas studimit të paraqitur nga subjekti, HEC DRITA do të ketë këto të dhëna:

Koordinatat e veprës së marrjes : X - 44 25 713 ; Y - 46 95 893 ; Z - + 312 m

Koordinatat e godinës së centralit: X - 44 25 801 ; Y - 46 94 083 ; Z - + 248.5 m

Koordinatat e pikes së shkarkimit : X - 44 25 801 ; Y - 46 94 083 ; Z - + 248.5 m

Prurja mesatare e përroit: Q mes = 2.590 m³/sek;

Sasia e ujit që kërkohet të përdoret nga subjekti: Q llog = 4.200 m³/sek;

Prurja ekologjike: Q ekol = 0.140 m³/sek;

Prurja që shkarkohet: Q = 4.200 m³/sek.

2- Autorizimi(miratimi ne parim) i përdorimit të burimit ujor për prodhim energjie elektrike jepet me kusht që të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zonë dhe rezerva e domosdoshme ekologjike.

3- Ngarkohet A.B.U. Drin-Bunë për zbatimin e këtij vendimi.

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË

SEKRETAR

Raimonda GURI



KRYETAR

Cesk MILLJA

